



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

PROJEKT-VENDIM

Nr.____,date____.01.2026

PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT ME POSTËN SHQIPTARE Sh.A., FILIALI KORÇË, PËR ARKËTIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”, Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.9001 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Kryetari i Bashkisë Kolonjë në mbledhien e Këshillit Bashkiak të dates 27.01.2026

PROPOZOI:

1. Miratimin e lidhjes së Kontratës së Shërbimit ndërmjet Bashkisë Kolonjë dhe Postës Shqiptare Sh.A., Filiali Korçë, për arkëtimin e taksave, tarifave dhe detyrimeve të tjera vendore.
2. Shërbimi i arkëtitimit përfshin pranimin e pagesave nga taksapaguesit, lëshimin e dokumentacionit përkatës financiar dhe transferimin e shumave të arkëtuara në llogaritë bankare të Bashkisë Kolonjë.
3. Afati i kontratës do të jetë 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Kolonjë.
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETAR
PETRO RISTO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr. 581 / prot

Ersekë më 22 / 01 / 2026

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM

NR. ____ DATË. ____ .01.2026

PËR MIRATIMIN E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT ME POSTËN SHQIPTARE Sh.A., FILIALI KORÇË, PËR ARKËTIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Të nderuar këshilltar !

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54, gërma e), Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat Vendore”, Ligji nr. 46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.9001 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Ky relacion shpjegues paraqitet për miratimin e Projektë Vendimit “Për miratimin e lidhjes së kontratës së shërbimit me Postën Shqiptare Sh.A., Filiali Korçë, për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore”, me qëllim përmirësimin e eficiencës në mbledhjen e të ardhurave vendore të Bashkisë Kolonjë. Administrimi i të ardhurave vendore përbën një nga funksionet kryesore të pushtetit vendor, i cili ndikon drejtpërdrejt në realizimin e buxhetit vjetor dhe në financimin e shërbimeve publike për qytetarët. Në këtë kuadër, krijimi i mekanizmave lehtësues për pagesën e detyrimeve vendore është një domosdoshmëri.

Aktualisht, një pjesë e taksapaguesve përballet me vështirësi në kryerjen e pagesave të taksave dhe tarifave vendore, për shkak të distancës, kufizimit të sporteleve apo mungesës së alternativave të pagesës. Kjo situatë ndikon negativisht në nivelin e arkëtimeve dhe në përmbushjen e planit të të ardhurave. Posta Shqiptare Sh.A., si operator publik me shtrirje territoriale të gjerë dhe eksperiencë në ofrimin e shërbimeve financiare, paraqet një mundësi të besueshme për ofrimin e shërbimit të arkëtitimit në emër të Bashkisë Kolonjë.

Lidhja e kontratës së shërbimit me Postën Shqiptare Sh.A., Filiali Korçë, synon:

- rritjen e nivelit të arkëtimeve të taksave dhe tarifave vendore;
- lehtësimin e procedurave të pagesës për qytetarët dhe bizneset;
- uljen e vonesave dhe detyrimeve të prapambetura;
- rritjen e transparencës dhe sigurisë në procesin e arkëtitimit.

Ky bashkëpunim krijon kushte më të favorshme për përmbushjen e detyrimeve fiskale dhe rrit besimin e taksapaguesve ndaj administratës vendore.

Zbatimi i këtij projekt-vendimi nuk krijon kosto shtesë të konsiderueshme për buxhetin e

Bashkisë Kolonjë, pasi pagesa e shërbimit do të realizohet sipas kushteve të kontratës dhe në


përputhje me legjislacionin në fuqi. Përkundrazi, pritet një rritje e të ardhurave vendore si rezultat i përmirësimit të procesit të arkëtimit.

Në përfundim, miratimi i këtij projekt-vendimi dhe lidhja e kontratës së shërbimit me Postën Shqiptare Sh.A., Filiali Korçë, përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të administrimit financiar vendor dhe përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve.

Për këto arsye, propozohet miratimi i Projekt-Vendimit nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kolonjë.

Ju faleminderit!

Konceptoi: F.Diko
Pranoi: E. Vogji
Konfirmoi: O. Lifo



Specialis Drejtorja e të Ardhurave
Drejtor Drejtorja e të Ardhurave
Drejtorja D.Ç.J.P.P

KRYETARI
ERION ISAI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
N/KRYETAR
PETRO RISTO

